



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:197174

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05639038

C.nr.3114/18

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Valentina Sopjani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.M, nga Fushë Kosova, të cilin sipas autorizimit bartës e përfaqëson Katriot Feka, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sokol Dardha, jurist i diplomuar, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e objektit të kontestit 30,600.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publikë me datë 22.04.2024, me datë 30.04.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit B.M nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t'ia paguaj shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jo material:

- Kompensimin në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike (trupore) shumë prej 4,000.00€.
- Kompensimin në emër të frikës, shumë prej 3,500.00€.
- Kompensimin për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 9.79%, shumë prej 4,000.00€.

Në emër të dëmit material:

- Kompensimin në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 336.00€.
- Kompensimin në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 336.00€.
- Në emër të shpenzimeve të shërimit shumë prej 08.00€.

- II. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë që paditësit B.M, shumat e gjykuara sikurse në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit jo material t'ia paguaj me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, nga data e marrjes së aktgjykimit (30.04.2024), e deri në pagesën definitive. Për kompensimin e dëmit material t'ia paguajë me kamatën ligjore në lartësi prej 8% në vit, nga dita e paraqitjes së padisë (22.10.2018), e deri në pagesën definitive.
- III. DETYROHET paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1.148.08€, në afati prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.
- IV. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit B.M, mbi shumat e gjykuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: në emër të kompensimit për dhimbjet fizike në shumë prej 3,000.00€, dhimbje shpirtërore për frikën e përjetuar shumë prej 3,500.00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 6,000.00€, në emër të kompensimit për ndihmë dhe kujdes të huaj në shumë prej 2,664.00€, në emër të kompensimit për ushqim të përforcuar shumë prej 2,664.00€, kompensimin në emër të shpenzimeve të shërimit në shumë prej 1,492.00 euro si dhe kamata ligjore mbi lartësinë e gjykuar sipas pikës II të këtij dispozitivi, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 22.10.2018, kanë paraqitur padit kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e trafikut të ndodhur me datë 24.07.2018, në fshatin Bardh i Madh, në cilësinë e pasagjerit, pasi që automjeti i cili ka shkaktuar aksidentin ka qenë me tabela të Anglisë, por ka pasur sigurim kufitar me numër të polisës sigurorese të auto përgjegjësive, e që përgjegjësia bie mbi të paditurën.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese nga palët ndërgjyqjese, pasi që e paditura në përgjigje në padi nuk e ka kontestuar bazën juridike, por ka qenë kontestuese lartësia e kërkesëpadisë. Tutje ka deklaruar se deri te aksidenti i trafikut ka ardhur me fajin e automjetit i cili ishte me targa të Anglisë dhe me polisë të sigurimit kufitar, gjersa ka qenë duke drejtuar veturën nga Drenasi në drejtim të Sllatinës dhe me të arritur në fshatin Bardh i Madh, përball KEK-ut, shoferi i veturës duke lëvizur me shpejtësi të madhe se sa parashihej në tabela, humb kontrollin mbi automjetin

duke kaluar në anën e majtë të drejtimit të lëvizjes, i njëjti duke u bartur në anën e djathtë të veturës e godet një këmbësor, i cili ishte në lëvizje dhe pastaj e godet shtyllën elektrike dhe një objekt, ku si pasojë e këtij aksidenti paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ka deklaruar se lëndimet e rënda trupore kanë rezultuar me thyerje të pëlvikut, thyerje të brinjëve të gjoksit dhe të kraharorit si dhe lëndime të rënda në kokë. Si rezultat i lëndimeve të marra, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të ndryshëm, dhimbje shpirtërore, gjithashtu ka qenë i nevojshëm edhe ushqimi i përforcuar, trajtimi me terapi mjekësore, trajtimi nga psikologu si dhe janë shkaktuar shpenzime të mjekimit të cilat dokumentohen me fatura dhe kuponë fiskal. Tutje ka shtuar se paditësi për realizimin e dëmit i është drejtuar të paditurës me datë 09.08.2018, ku e paditura me njoftimin për trajtimin e dëmit, e ka pranuar përgjegjësinë dhe ka dhënë ofertën, mirëpo një ofertë e tillë ka qenë e papranueshme për paditësin, pasi që si e tillë nuk përbënte satisfaksion. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësot sipas precizimit të datës 22.04.2024 dhe të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit jo material paditësit t' ia kompensojë shumën prej 7,000.00 euro në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 7,000.00 euro në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 10,000.00 euro në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, kurse për dëmin material t' ia kompensoj shumën prej 3,000.00 euro në emër të ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 2,100.00 euro si dhe në emër të shpenzimeve të shërimit sipas faturave shumën prej 1,500.00 euro, me kamatë ligjore prej 12 % nga momenti i paraqitjes së kërkesës tek e paditura e gjerë në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 10,000.00 euro sipas Tarifës së Odës së Avokatëve.

E paditura përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në padi, përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, nuk e ka kontestuar bazën juridike të padisë lidhur me shkakun e aksidentit, mirëpo e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë, për dëmin jo material dhe material që ka pësuar paditësi. Tutje ka deklaruar se kontestuese është lartësia e kërkesës për dëmin jo material pasi që shumat e kërkuara nuk janë në harmoni me intensitetin e dhimbjeve, frikës së përjetuar si dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor, ndërsa sa i përket formave të dëmit material i konteston ato forma të dëmit material të cilat nuk argumentohen me prova konkrete si fatura dhe apo kupon fiskal. Ndërsa sa i përket kamatës ligjore i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta njohë në shumën prej 8 % sipas nenit 36 të LSDA-së dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Raportin e aksidentit të datës 24.07.2018, dokumentacioni mjekësor me numër rendor të protokollit 28484 i datës 24.07.2018, fletë lëshimin me epikrizë, me numër amëz 5779 e lëshuar nga QKUK, raportet nga konsulta, faturat me numër A367234, A422119, A367124, si dhe ekspertizën mjekësore të datës 21.03.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues baza juridike e kërkesëpadiisë, mirëpo kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kërkesëpadiisë në emër të kompensimit të të gjitha formave të dëmit material dhe jo material.

Nga i tërë dokumentacioni mjekësor që e ka administruar gjykata për këtë çështje juridike, konstatohet se paditësi për shkak të lëndimeve të pësuar si pasagjer në vetë aksidentin e ndodhur me datë 24.07.2018, ka qenë i detyruar të marr trajtime/shërbime mjekësore. Megjithatë, për t'i vërtetuar ekzistimin e lëndimeve të paditësit dhe natyrën e tyre, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë – traumatologjisë dhe psikiatrisë dhe për ekspert ka caktuar ekspertët mjekësor, Sabit Sllamniku dhe Jeton Zogaj, të cilët kanë bërë vlerësimin mjekësor të paditësit duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të saj. Mbi bazën e ekspertizës mjekësore, është konstatuar se paditësi në aksidentin e trafikut të lartë theksuar, ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Ekspertët e caktuar nga ana e gjykatës kanë konstatuar se në momentin e dëmtimit dhe gjatë trajtimit mjekësor paditësi ka pasur dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të lartë disa sekonda deri në humbjen e vetëdijes, intensitet të lartë 3 ditë. Me intensitet të mesëm 4 javë të tjera, me intensitet të ulët, kronike ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë ngarkimeve fizike, qëndrimit të gjatë në këmbë, pozita të veçanta të shpinës etj. Përmes ekspertizës është konstatuar se paditësit ka përjetuar frikë primare të shkurtër që ka zgjatur 2- 3 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 7-10 ditë, frikë

sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 15-20 ditë si dhe frikë e intensitetit të ulët që ka zgjatur në periudhë kohore prej më shumë se 2 muaj deri në disa vite pas aksidentit.

Sipas vlerësimit të ekspertëve mjekësor, paditësi nga aksidenti i datës 24.07.2018 ka pësuar zvogëlim të përgjithshëm të aktivitetit jetësor në shkallë prej 9.79% sipas rregullores së Balthazarit dhe BQK e miratuar nga MSH, e shprehur në humbje të vetëdijes për shkak të comocionit 3% si dhe zvogëlim i lëvizshmërisë së boshtit kurrizor për shkak të thyerjeve të proceseve trabsverse th- 8 dhe th 11 në shkallë prej 7 %. Kurse shëmtim trupor tek paditësi nuk ekziston.

Ndërsa sa i përket ndihmës dhe kujdesit të huaj, dhe sipas mendimit të ekspertëve, paditësi ka pasur nevojë për ndihmë në kohëzgjatje prej 6 javë, që nënkupton ndihmë në ushqim, veshmbathje dhe nevoja higjienike. Ndërsa emër të ushqimit të përforcuar si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javë, dhe atë ushqim i pasur me minerale, vitamina, proteina. Kurse rehabilitimi klimetariko banjor ka qenë i nevojshëm për dy javë brenda vitit të parë pas lëndimit.

Ekspertizën e lartpërmendur gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i dha besimin e plot, kjo sepse ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata në bazë të provave të administruara, në emër të dhimbjeve fizike aprovoj kërkesëpadinë e paditësit B.M, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që ka të bëjë me dhimbjet fizike, shumë prej 4,000.00 €, të cilën e vlerësoj si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të eksperteve mjekësor të dhënë në super ekspertizën e datës 21.03.2024, paditësit në momentin e lëndimit i është shkaktuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të lartë disa sekonda deri në humbjen e vetëdijes, intensitet të lartë 3 ditë. Me intensitet të mesëm 4 javë të tjera, me intensitet të ulët, kronike ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë ngarkimeve fizike, qëndrimit të gjatë në këmbë, pozita të veçanta të shpinës etj. Për këto arsye Gjykata e caktoj këtë shumë duke u bazuar në natyrën e lëndimit, pasojave, si dhe moshën e paditësit në kohën e shkaktimit të lëndimeve i cili ka qenë i mitur në moshën 16 vjeqare si dhe intensitetin e dhimbjeve.

Në emër të frikës së pësuar për paditësin B.M, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 3,500.00€, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga mendimi i dhënë në ekspertizën mjekësore të psikiatrisë më datë 21.03.2024, ku me këtë rast të paditësi ka përjetuar frikë primare të shkurtër që ka zgjatur 2- 3 sekonda, frikë sekondare të

intensitetit të lartë që ka zgjatur 7-10 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 15-20 ditë si dhe frikë e intensitetit të ulët që ka zgjatur në periudhë kohore prej më shumë se 2 muaj deri në disa vite pas aksidentit. Për këto arsye Gjykata e caktoj këtë shumë duke u bazuar në natyrën e frikës, kohëzgjatjen, moshën e paditësit në kohën e shkakimit të lëndimeve i cili ka qenë i mitur në moshën 16 vjeqare si dhe intensitetin e frikës.

Gjykata në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për paditësin B.M, ka caktuar shpërblimin, në shumë prej 4,000.00€, duke u bazuar në ekspertizën mjekësore, ku është konstatuar se zvogëlimi i aktivitetit të përhershëm jetësor është në shkallën prej 9,79%. Kjo përqindje është si pasojë e humbjes së vetëdijes për shkak të comocionit dhe zvogëlimin e lëvizshmërisë së boshtit kurrizor për shkak të thyerjeve të proceseve trabsverse TH8 – TH 11. Gjykata e vlerësoj si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit duke u bazuar në mendimin e dhënë nga ana e ekspertëve mjekësor.

Për lartësinë e kërkesëpadisë për dëmin material që i referohet ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë si dhe ushqimit të përforcuar gjykata vendosi duke u bazuar në konstatimet e eksperteve gjyqësorë të cilët në mendimin e tyre profesional kishte konstatuar se: “Sa i përket ndihmës dhe kujdesit të huaj, paditësi ka pasur nevojë për ndihmë në kohëzgjatje prej 6 javë, ndërsa emër të ushqimit të përforcuar si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javë.” Andaj, gjykata e mori si të mirëqenë kërkesën e paditësit për këtë lloj të dëmit material-Ushqimi i përforcuar dhe Ndihma e përkujdesja e huaj, duke u bazuar në praktikën gjyqësore dhe duke vlerësuar se nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejt. Dhe nuk duhet të shkoj përshtati synimeve të padrejta dhe vlerësoi si të pa drejtë shumat e kërkuar përtej shumës së aprovuar, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo edhe për faktin e njohur se ndihma e personit të huaj dhe ushqimi i përforcuar nuk mund të jetë pa një shpërblim të caktuar, pavarësisht faktit se të njëjtat nuk janë argumentuar me prova konkrete.

Kurse në raport me lartësinë e kategorisë së dëmit material përkitazi me shpenzimet e shërimit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoj faturat A367234, A422119 dhe A367124, nga të cilat fatura vërtetohet fakti se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit për lëndimet e pësuar nga aksident i datës 24.07.2018, në shumën prej 8.00 euro.

Për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuar të dëmit jo material, gjykata vendosi në kuptim të nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, sipas të cilit është paraparë që “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës”, gjykata po të konstatojë nga rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”.

Rrjedhimisht gjykata për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së dëmit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, intensitetin frikës, çmuarjen e lirë të provave, rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar si dhe praktikën gjyqësore, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfakcion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësve, ngase shpërblimi i dëmit jo material në të holla nuk është shpërblim i plotë, por siç u theksua më lartë është një satisfakcion për të dëmtuarin në kuptimin e të drejtës së tij.

Gjykata për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit material, përkatësisht përkujdesjen dhe ndihmën e personit të tretë si dhe ushqimin e përforcuar si dhe shpenzimet rreth mjekimit, vendosi konform nenit 179 të LMD-së e cila parasheh “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.”

Bazuar në të lartcekurat gjykata ka ardhur në përfundim se shumata e gjykuara janë në përputhje me dëmin e pësuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, ku obligohet e paditura që për të gjitha këto kategori të dëmit që iu janë shkaktuar paditësve është përgjegjëse për ti kompensuar.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Kurse për pjesën refuzuese në raport me dëmin material gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se nga ana e palës paditëse gjykatës nuk i është ofruar

asnjë provë me të cilën kishte me u vërtetuar lartësia e kërkesave të pretenduar, përtej atyre shumave të aprovuara. Andaj në mungesë të dëshmive për dëmin material e në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së e cila përcakton “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla” si dhe nenit 319.1 e cila parasheh “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, gjykata vendosi si në diapozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar.

Gjykata i pati parasysh edhe pretendimet e tjera të të paditurës, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara, dhe pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes.

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoi në nenin 382 paragrafi 2 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimit (30.04.2024), sa i përket kompensimit të dëmit jo material sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata ka vendosur dhe nga ai moment, kërkesa e paditëses për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit. Ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit material nga data e paraqitjes së padisë 22.10.2018, në lartësi prej 8% në vit.

Gjykata refuzoj lartësinë e kamatës përtej vlerës prej 8% në vit, kjo sepse përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në padinë e datës 18.10.2024, ka pohuar faktin se e paditura me njoftimin për trajtimin e dëmit e ka pranuar përgjegjësinë dhe ka dhënë ofertën, e që në bazë të këtij pohimi, del se nuk plotësohen kushtet nga neni 26 paragrafi 6 të LSDA e cila përcakton për aprovimin e kamatës në lartësi prej 12%, por vetëm në kamatën ligjore prej 8% në vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 449 dhe 452 par 1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,148.08€, dhe atë në emër të taksës për padi shumën prej 100.00 euro, në emër të përpilimit të padisë shumën prej 208.00€, për 2 seanca shumën prej 540.80€ (secila seancë nga 270.40€), për ekspertizë mjekësore shumën prej 300.00€. Shuma e aprovuar nga gjykata është në përputhje me Tarifën e Odës së Avokatëve.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3114/18, datë 30.04.2024

Gjyqtarja

Valentina Sopjani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.